

LIGJ
Nr. 100/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 43/2023,
“PËR QEVERISJEN ELEKTRONIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 37 ndryshohet si më poshtë:

“37. “Shërbim publik elektronik” është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe të qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë në bazë të kërkesave të tyre dhe që rezulton në një përgjigje të formave të ndryshme, si: certifikatë, licencë, leje, vërtetim etj., nga institucioni përgjegjës i parashikuar në ligj.”.

2. Pas pikës 46 shtohet pika 47 me këtë përmbajtje:

“47. “Riinxhinërim” është procesi që synon thjeshtëzimin e procedurave administrative të nevojshme për përfitimin e një shërbimi, të dokumentacionit përkatës apo të proceseve të tjera të lidhura me lëvrimin e shërbimit edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit.”.

Neni 2

Në shkronjën “c”, të nenit 8 shkurtesa “BCC” bëhet “BC” dhe shkurtesa “DRC” bëhet “DR”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “ç” fjalët “në të cilën shërbimet dhe sistemet nuk mund të jenë funksionale;” zëvendësohen me fjalët “të pranueshme, në të cilën shërbimet dhe sistemet mund të mos jenë funksionale;”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoritetet publike/subjektet private, përgjegjëse për ofrimin e shërbimit elektronik, përpara vënies në punë të sistemeve apo të shërbimeve elektronike, janë të detyruara të përmbushin minimalisht standardet qeveritare të TIK-ut dhe standardet e shërbimeve publike elektronike (*e-shërbime*), që miratohen me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të AKSHI-t.”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 4

Në pikën 5, të nenit 11 pas fjalëve “bëjnë ruajtjen e” shtohen fjalët “të paktën një kopje të”.

Neni 5

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pranë AKSHI-t krijohet dhe funksionon Bordi Këshillimor për Teknologjinë e Informacionit, si organ konsultativ për çështjet e teknologjisë dhe informacionit.”.

2. Në pikën 4 fjalët “Komitetit Ndërmintor për Teknologjinë dhe Inovacionin” zëvendësohen me fjalët “Bordit Këshillimor për Teknologjinë e Informacionit”.

Neni 6

Shkronja “c” e nenit 25 ndryshohet si më poshtë:

“c) ofron shërbimet e autentifikimit, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike dhe certifikatës elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike, dhe subjektet private, shtetasit shqiptarë dhe/ose të huaj, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave;”.

Neni 7

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) përcakton standardet qeveritare të TIK-ut dhe standardet e shërbimeve publike elektronike (*e-shërbimet*) në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga institucionet e administratës shtetërore dhe subjektet private.”.

2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) harton Kornizën Kombëtare të Ndërveprimit në Republikën e Shqipërisë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Shkronja “h” e nenit 29 shfuqizohet.

Neni 9

Në pikën 2, të nenit 30 fjalët “një zëvendësdirjtor” zëvendësohen me fjalët “dy zëvendësdirjtore”.

Neni 10

Në nenin 34 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dirjtori i përgjithshëm dhe nëpunësit e njësisë teknike të përmbajtjes së AKSHI-t, përveç pagës sipas kategorive të pagës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune. Masa e shtesës për natyrë të veçantë për secilën kategori përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Në shkronjën “dh”, të nenit 37 fjalët “dhe qendrën e ruajtjes së informacionit (*backup center*)” zëvendësohen me “dhe sistemet e ruajtjes së informacionit (*backup systems*)”.

Neni 12

Në nenin 54 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Projektet TIK në administratën publike zhvillohen dhe projektohen duke garantuar ndërveprueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 57 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 hiqen fjalët “9, pika 3”, “29, shkronja “h”,” dhe “54, pika 2,” dhe shtohen fjalët “27, shkronja “ë”, dhe 34”.

2. Në pikën 2 pas fjalëve “në zbatim” shtohen fjalët “dhe të pikës 2, të nenit 9”.

Neni 14

Dispozita kalimtare

Trajtimi i punonjësve ekzistues të ADISA-s do të bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon marrëdhënien e tyre të punës.

Neni 15

Shfuqizime

Ligji nr. 13/2016, “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.9.2024.

Shpallur me dekretin nr. 350, datë 1.10.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.